



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/15
Datë: 10.04.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti i mbledhjes së 14 të Qeverisë së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/15

Datë: 10.04.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill 2008, mori

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni që do të përgatis ofertën e shprehjes së interesit për ndërtimin e autostradës Vermicë-Merdare, në këtë përbërje:
 - Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (kryesues)
 - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
 - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
 - Ministria e Ekonomisë dhe Financave
 - Zyra e Kryeministrit
2. Obligohet Komisioni që brenda javës të përgatis dhe publikojë shprehjen e interesit për këto auto-rrugë apo pjesë të saj.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/15

Datë: 10.04.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet në parim, kërkesa e Këshillit Organizativ të Shoqatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – (dega Rahovec), për financimin e projektit “Ngritja e lapidarit në komunën e Rahovecit”.
2. Mjetet financiare në shumën 8,000.00 Euro për realizimin e projektit sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të transferohen nga kodi 005 i MPMS-së, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në llogarinë bankare të Këshillit Organizativ të Shoqatës së Veteranëve të UÇK-së, nr. 1505010000351696, në Raiffeisen Bank.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/15
Datë: 10.04.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill 2008, mori

V E N D I M

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal caktohet përfaqësuese koordinative për ndihmat e jashtme që u ofrohen Komunave të Kosovës.
2. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal funksionon si partner i Qendrës për Koordinimin me Donatorë e themeluar në Zyrën e Kryeministrit, me qëllim të bashkërendimit dhe arritjes se efektivitetit maksimal të të gjitha ndihmave të jashtme të ofruara nga donatorët bilateral e multilateral për zhvillim e Komunave të Kosovës.
3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal siguron dhënien e informatave rreth ndihmave të jashtme të ofruara në Komunitat e Kosovës për të pasur alokim të mirëfilltë të ndihmave të jashtme të ofruara për zhvillim në Komunitat e Kosovës.
4. Obligohen të gjitha ministratë e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe komunitat për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/15

Datë: 10.04.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për formimin e Grupit ndërministror për përcaktimin e kriterëve për numrin e të punësuarve në Administratën komunale.
2. Grupi ndërministror përbëhet nga:
 - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (kryesues)
 - Ministria e Ekonomisë dhe Financave,
 - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
 - Ministria e Shërbimeve Publike,
 - Ministria e Shëndetësisë dhe
 - Asociacioni i Komunave të Kosovës
3. Anëtari i deleguar në Grupin Punues duhet të jetë zyrtar i lartë i rangut të drejtorit të departamentit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/15
Datë: 10.04.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet, me ndryshime, Projektligji për Statistikat Zyrtare në Republikën e Kosovës.
2. Obligohet Zyra për Shërbimet e Ndihmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit për inkorporimin e vërejtjeve.
3. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/15
Datë: 10.04.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill 2008, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjetet financiare për kompensimin e obligimeve të mbetura për Komisionin Kushtetues, Grupin për Simbole (flamurin dhe stemën) dhe Himnin e Republikës së Kosovës për periudhën Qershor 2007 – Prill 2008.
2. Mjetet e ndara nga pika 1 e këtij vendimi sigurohen nga fondi për organizimin e ceremonive institucionale dhe festave në ditën e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, Zyra e Kryeministrit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/15
Datë: 10.04.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill 2008, mori

V E N D I M

1. Plotësohet vendimi i Qeverisë nr. 05/14, i datës 03.04.2008 me anëtarët e propozuar për Organin Shqyrtues të Prokurimit:
 - Lulzim Blakaj
 - Tefik Sylejmani
2. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që emrat e kandidatëve të përcaktuar nga pika 1 e këtij vendimi së bashku me CV-të e tyre t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/14
Datë: 03.04.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 prill 2008, mori

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit të Kosovës për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit (me mundësinë e plotësimi edhe me dy anëtarë) këta kandidatë:
 - a) Hysni Hoxha
 - b) Ahmet Krasniqi
 - c) Demë Keka
2. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që emrat e kandidatëve të përcaktuar nga pika 1 e këtij vendimi, së bashku me CV-të e tyre, t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë